



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E POLICISË SË SHETIT**

Nr. 949/1 Prot., datë 31.1.2025



**AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË**

Nr. 192/1 Prot., datë 04.022025

RINOVIM

I

MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETIT

DHE

AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

**“PËR PËRGATITJEN DHE ZBATIMIN E PROJEKTEVE TË PËRBASHKËTA
KËRKIMORE-SHKENCORE”**

E lidhur sot më datë __.__. 2025 ndërmjet palëve:

Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me adresë Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë,
përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit **Drejtues Madhor Ilir PRODA**

dhe

Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me adresë Sheshi “Fan S. Noli”, nr. 7, Tiranë,
përfaqësuar nga Kryetari i Akademisë së Shkencave, **Akademik Skënder GJINUSHI**.

Rinovimi i kësaj marrëveshje bazohet në germën “i”, të pikës 2, të nenit 55, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, pikën 4, të nenit 128, të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 298, datë 15.5.2024, të Këshillit të Ministrave,

“Për ngritjen e njësisë së kërkim-studimit me aktivitet afatgjatë “Qendra kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës”, vendimin e Kryesisë së Akademisë së Shkencave me nr. 59, datë 6.6.2024 “Për strukturën e organikën e Qendrës kërkimore të Bioteknologjisë e Gjenetikës” dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Shkencave “Për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore”.

Palët e mësipërme bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim rinovimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (në vijim DPPSH) dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (në vijim ASHSH) “Për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore”, e nënshkruar nga DPPSH me nr. 4546/2 prot., datë 12.8.2022 dhe nga ASHSH me nr. 450/3 prot., datë 29.8.2022, me të njëjta kushte, ku përcaktohet rregullimi i bashkëpunimit ndërinstitucional midis Palëve, si dhe midis strukturave përbërëse të tyre dhe përcaktimin e prioriteteve themelore të bashkëpunimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi e në parime të gjithë pranuar dhe në interesa të përbashkët.

Neni 2

Pikat e kontaktit

1. Pikë kontakti për komunikimin e vazhdueshëm në kuadër të realizimit të objektivave të marrëveshjes së rinovuar, do të jenë:
 - a) Për Institutin e Policisë Shkencore z./znj. Elidion Rusto, me detyrë ekspert biolog në Sektorin e Biologjisë, me adresë e-maili elidion.rusto@asp.gov.al dhe nr. Telefoni +355694119878.
 - b) Për Qendrën Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, z. Ilia Mikerezi, me detyrë anëtar i Qendrës, me adresë e-maili: imikerezi@yahoo.com dhe me nr. telefoni +355673102495.

Neni 3

Ndryshime

1. Në nenin 5 “Të drejtat dhe detyrimet e Institutit të Policisë Shkencore”, të shtohet germa “c”, me përmbajtje:

- c) Personat e autorizuar nga qendra për të hyrë në ambientet e laboratorit të Biologjisë në IPSH, do të zbatojnë të gjitha rregullat e nevojshme në zbatim të procedurave standarde sipas ISO 17025.

Neni 4
Dispozita të fundit

1. Rinovimi i kësaj marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga Palët dhe do të zbatohet për një periudhë 2 (dy) vjeçare, me të drejtë rinovimi.
2. Kushtet e tjera në marrëveshje, mbeten të pandryshuara.
3. Ndryshimet në marrëveshje mund të bëhen me pëlqimin me shkrim të Palëve.
4. Ky rinovim i marrëveshjes hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje autentike, ku të gjitha tekstet janë identike në përputhshmëri të plotë, ku secila palë mban 2 (dy) kopje.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E POLICISË SË SHETIT**

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Drejtues Madhor Ilir PRODA



**AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRSIË**

KRYETARI
Akademik Skënder GJINUSHI

